STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 14 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON FONDIN E HUAVE TE EMERGJENCES PER BIZNESET E VOGLA PER TE SIGURUAR ASISTENCE PER BIZNESET E PREKUR NGA SENDI (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shoqata e Bankierëve të Nju Jorkut (NYBA) dhe Korporata e Zhvillimit të Biznesit e Nju Jorkut (NYBDC) kanë vendosur të krijojnë një fond të huave për bizneset e vogla prej 10 milionë dollarë për të siguruar asistencë financiare të menjëhershme për bizneset e prekura nga Stuhia Sendi (Sandy). Sipas fondit, bizneset do të jenë në gjendje të bëjnë kërkesë për hua deri në 25,000 dollarë menjëherë duke shkuar në www.esd.ny.gov ose duke telefonuar në 1-855-NYS-SANDY.

"Bankat e Nju Jorkut janë duke vepruar për të ndihmuar bizneset e vogla të shtetit tonë që të rindërtohen dhe të rihapen pas Uraganit Sendi (Sandy)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Ky program i huave do të ndihmojë ato biznese që u goditën më rëndë nga stuhia që të marrin burimet që u nevojiten për t'u riparuar menjëherë, duke u lejuar atyre që të vazhdojnë të sigurojnë vende punë për komunitetet tona dhe forcë për ekonominë tonë. Përgëzoj Shoqatën e Bankierëve të Nju Jorkut për sigurimin e ndihmës për këto biznese dhe për bashkimin me përpjekjet në rritje të sektorit privat për të ndihmuar që të gjithë banorët e Nju Jorkut të rimëkëmben."

Majkëll P. Smith (Michael P. Smith), President & CEO, Shoqata e Bankierëve të Nju Jorkut tha, "Industria bankare e kupton se rimëkëmbja e shpejtë e bizneseve të vogla do të jetë kryesore për rindërtimin e lagjeve tona. Jemi të zellshëm që të ndihmojmë në këtë përpjekje të rëndësishme, në mënyrë që pronarët e bizneseve të vogla të Nju Jorkut të rifillojnë nga puna dhe të rifillojnë sigurimin e mallrave dhe shërbimeve në komunitetet e tyre."

Programi i huave të emergjencës do të sigurojë hua me interes të ulët prej deri në 25,000 dollarë për bizneset e vogla në një mënyrë të përshpejtuar për të ndihmuar në përpjekjet e rimëkëmbjes. Korporta e Zhvillimit të Biznesit e Nju Jorkut do të administrojë dhe do të vërë në funksionim programin, në bashkërendim me Zhvillimin e Empire State (ESD).

Nëpërmjet programit, bizneset e vogla në komunitetet e prekura do të kenë të drejtë të marrin hua prej deri në 25,000 dollarë që do të jenë pa interes dhe pa pagesa për gjashtë muajt e parë dhe pastaj me një interes prej një përqind për dy vitet e ardhshme. Bizneset që kualifikohen mund t'a përdorin financimin për të mbuluar kostot e zëvendësimit dhe riparimeve të mjediseve ose pajisjeve ose si kapitalin e punës të nevojshëm për të rifilluar ose vazhduar funksionet e biznesit.

Program i huave të emergjencës është për bizneset në pronësi dhe përdorim të pavarur që kanë më pak se 100 punonjës dhe janë të vendosura në qarqet e caktuara si rajone të katastrofës: Oranxh (Orange), Putnëm (Putnam), Roklënd (Rockland), Sallivën (Sullivan), Ulstër (Ulster), Uestçester (Westchester), Naso (Nassau), Safolk (Suffolk) dhe pesë rrethet e Qytetit të Nju Jorkut.

Për t'u kualifikuar për marrjen e financimit nëpërmjet programit, ndërmarrjet duhet të kenë paraqitur dokumentat e taksave të biznesit për 2011-tën dhe të kenë përjetuar dëm të drejtpërdrejtë ose vështirësi ekonomike si rezultat i Sendit (Sandy). Kërkesat do të jenë në dispozicion brenda javës dhe bizneset pritet të fillojnë të marrin financimin pesë deri në shtatë ditë pas paraqitjes së një kërkese të plotë dhe dokumentacionit të kërkuar.

Presidenti, CEO & Komisioneri i Zhvillimit të Empire State Keneth Adams (Kenneth Adams) tha, "Rimëkëmbja e komuniteteve tona varet nga aftësia e bizneseve vendore të tyre që të kenë burimet që u nevojiten për t'u rikthyer në biznes. Nën drejtimin e Guvernatorit Kuomo (Cuomo), shteti është duke siguruar ndihmë të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për të ndihmuar ata që kanë nevojë më shumë për të gjatë këtyre kohërave të vështira."

Kris Xhiamo (Chris Giamo) , Presidenti Rajonal për Nju Jorkun dhe Nju Xhërsin e Veriut, TD Bank tha, "TD Bank është krenare të japim mbështetjen tonë për këtë përpjekje kaq të rëndësishme, e cila do të ndihmojë në rimëkëmbjen dhe mbështetjen e bizneseve ndërsa rimëkëmbja nga Uragani Sendi (Sandy) ecën përpara. Mendimet tona janë me ata që janë prekur nga kjo katastrofë natyrore dhe mezi presim të shohim rezultatet e këtij investimi në komunitetin e gjerë të Nju Jorkut."

Xhonathan Uitër (Jonathan Witter), President i Shërbimeve Bankare me Pakicë dhe të Drejtëpërdrejta për Capital One tha, "Pronarët e bizneseve të vogla anembanë shtetit pritën më të keqen kur u kthyen për të vëzhguar dëmin e shkaktuar nga stuhia dhe, në shumicën e rasteve ishte saktësisht ajo që gjetën. Nju Jorku është shtëpia e Capital One dhe shumë prej bashkëpunëtorëve tanë janë të përkushtuar që të ndihmojnë pronarët e bizneseve të vogla që të rindërtojnë. Jemi krenarë që jemi në gjendje të mbështesim Fondin e Huave të Rimëkëmbjes së Bizneseve të Vogla për të ndihmuar bizneset e vogla vendore ndërsa fillojnë të rindërtojnë dhe të rimëkëmben nga kjo ngjarje shkatërruese."

Majkëll N. Vitorio (Michael N. Vittorio), President & CEO, First National Bank of Long Island tha, "The First National Bank of Long Island do të bëjë gjithshka që mundet për të punuar me komunitetin vendor dhe ata që janë prekur nga Uragani Sendi (Sandy). Eshtë e rëndësishme për ne të gjithë që të bashkohemi në këtë kohë."

Albanian

Hauard C. Bluver (Howard C. Bluver), President dhe CEO i National Bank në Qarkun Safolk (Suffok) në Rivërhed (Riverhead) tha, “Eshtë në kohëra si këto që bankierët duhet të sigurojnë mbështetje të shpejtë dhe plot kuptim për bizneset e vogla dhe komunitetet që janë prekur nga Sendi (Sandy). E përgëzojmë këtë përpjekje dhe jemi krenarë të bëjmë pjesën tonë.”

Xhejms J. Lendi (James J, Landy), Kryetar, Hudson Valley Bank tha, “Jemi krenarë që industria bankare në Nju Jork është duke kryesuar për të krijuar një fond të huave të emergjencës për rimëkëmbjen e bizneseve të vogla për të ndihmuar trajtimin e nevojave të numrit të madh të bizneseve të vogla të prekura nga Uragani Sendi (Sandy). Hudson Valley Bank ishte ndërmjet të parëve që u përkushtuan për të marë pjesë në fond sepse mendojmë se është e rëndësishme të ndihmojmë bizneset që të ngrihen përsëri në këmbë dhe të fillojnë të rimëkëmben nga pasojat shkatërruese të stuhisë. Individët, familjet dhe bizneset kanë përjetuar kaq shumë gjatë disa javëve të kaluara. Nëpërmjet këtij fondi, mund të bëjmë një kontribut plot kuptim për komunitetin e biznesit dhe të sigurojmë njëfarë ndihme të nevojshme.”

Xhon Burën (John Buran), President & CEO, Flushing Bank tha, “Ne tek Flushing Bank jemi krenarë të tregojmë mbështetjen tone për fondin e ndihmës për bizneset e vogla dhe të bashkohemi me kolegët tanë anembanë shtetit për të mbështetur bizneset e vogla dhe përpjekjet e tyre për t’u rimëkëmbur nga kjo katastrofë.”

Xhon R. Kolmel (John R. Koelmel), President & CEO, First Niagara, tha, “Bërja e lehtë që bizneset e vogla të bëjnë gjëra të mëdha është ajo për të cilën jemi këtu çdo ditë tek First Niagara. Prandaj, jemi krenarë që të bëhemi partnerë të Guvernatorit dhe kolegëve tanë bankierë për t’u siguruar se bizneset vendore janë në gjendje të rindërtohen dhe të rimëkëmben edhe më shpejt nga shkatërrimi i kësaj stuhie.”

E krijuar më 1955, NYBDC është një konsorcium bankash të angazhuara për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mundësitë e zhvillimit të vendeve të punës në Shtetin e Nju Jorkut duke siguruar hua të garantuara nga qeveria dhe hua tradicionale për bizneset e vogla në të gjitha fazat e zhvillimit. NYBDC punon me bankat anëtare të saj për të siguruar zgjidhje financimi krijuese, reaguese dhe me kosto të efektshme kur një alternativë tradicionale nuk është e disponueshme nëpërmjet huave të kapitalit të punës me afat të gjatë, të pajisjeve e të pronave të paluajtshme për një shumëllojshmëri biznesesh që ndodhen në Shtetin e Nju Jorkut, ose në pjesëmarrje me ose si një shtesë e industrisë bankare.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418